

LIGJ
Nr. 9718, datë 19.4.2007

PËR URDHRIN E INFERMIERIT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

(Ndryshuar me ligjin nr. 10462, datë 13.9.2011; nr. 124/2014, datë 25.9.2014; nr. 99/2024, datë 12.9.2024)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi i ligjit

(Shtuar togfjalësh me ligjin nr. 10462, datë 13.9.2011)

Ky ligj ka për qëllim të rregullojë marrëdhëniet juridike të profesioneve infermier, mami, fizioterapeft, teknik/e laborator, teknik/e imazherie, logopedist/e si dhe organizimin e Urdhrit të Infermierit.

Neni 2

Fusha e zbatimit

(Ndryshuar me ligjin nr. 10462, datë 13.9.2011)

Ky ligj e shtrin veprimtarinë e vet në të gjithë territorin e vendit dhe zbatohet për të gjithë infermierët/et, mamitë, fizioterapeftët/et, teknikët/et e laboratorit, teknikët/et e imazherisë dhe logopedistët/et, që ushtrojnë profesionin në Republikën e Shqipërisë.

Neni 3

Statusi

(Ndryshuar me ligjin nr. 10462, datë 13.9.2011)

Urdhri i Infermierit është ent publik jobuxhetor, i cili përfaqëson interesat e përbashkët të profesioneve të infermierit/es, mamisë, fizioterapeftit/es, teknikut/es të/së laboratorit, teknikut/es të/së imazherisë dhe logopedistit/es, si dhe rregullon marrëdhëniet ndërmjet tyre, në funksion të publikut.

KREU II
MISIONI DHE BUXHETI

Neni 4

Kriteret e anëtarësisë

(Shtuar togfjalësh në pikat 1, 2, 3 dhe 4 me ligjin nr. 10462, datë 13.9.2011)

1. Urdhri i Infermierit përbëhet nga infermierët dhe mamitë, fizioterapeft/e, teknik/e laborator, teknik/e imazherie dhe logopedist/e që kanë diplomën përkatëse dhe që e ushtrojnë profesionin në Republikën e Shqipërisë.

2. Shtetasit shqiptarë dhe të huaj, të diplomuar si infermierë ose mami, fizioterapeft/e, teknik/e laborator, teknik/e imazherie dhe logopedist/e në Republikën e Shqipërisë, bëhen menjëherë anëtarë të Urdhrit, me pagimin e kuotizacionit dhe regjistrimin pranë tij.

3. Anëtarë të Urdhrit të Infermierit bëhen edhe të gjithë infermierët dhe mamitë, fizioterapeft/e, teknik/e laborator, teknik/e imazherie dhe logopedist/e shtetas shqiptarë dhe të huaj, të diplomuar jashtë vendit, pas njohjes së diplomës, sipas legjislacionit në fuqi.

4. Shtetasi i huaj, që të ushtrojë profesionin e infermierit dhe mami, fizioterapeft/e, teknik/e laborator, teknik/e imazherie dhe logopedist/e në Republikën e Shqipërisë, duhet të jetë anëtar relativ i të njëjtit urdhër në vendin e vet ose në vendin ku së fundi ka ushtruar këtë profesion.

5. Përfshihen nga ky detyrim, por jo nga e drejta e anëtarësimit në këtë organizëm, nëpunësit e administratës shtetërore, për sa kohë ata nuk ushtrojnë veprimtari të mirëfilltë si infermier/e, mami, fizioterapeft/e, teknik/e laborator, teknik/e imazherie dhe logopedist/e.

Neni 5

Detyrimi për anëtarësi

(Ndryshuar togfjalësh në pikën 1 me ligjin nr. 10462, datë 13.9.2011)

1. Asnjë individ nuk mund ta ushtrojë profesionin e infermier/e, mami, fizioterapeft/e, teknik/e laborator, teknik/e imazherie dhe logopedist/e në Republikën e Shqipërisë pa qenë anëtar i Urdhrit të Infermierit.

2. Punëdhënësit e institucioneve shëndetësore, publike dhe private, të shërbimit shëndetësor parësor, dytësor dhe tretësor, ndalohen t'i punësojnë ata në kundërshtim me këtë dispozitë.

Neni 6

Misioni i Urdhrit të Infermierit

(Ndryshuar togfjalësia në pikën 1, në shkronjat "a", "c", "ç" dhe "d" të pikës 2 me ligjin nr. 10462, datë 13.9.2011; shtuar shkronja "e" e pikës 2 me ligjin nr. 124/2014, datë 25.9.2014)

1. Urdhri i Infermierit ka si mision ruajtjen e standardeve të miratuara nga Ministri i Shëndetësisë, në ushtrimin e profesionit infermier/e, mami, fizioterapeft/e, teknik/e laborator, teknik/e imazherie dhe logopedist/e, nëpërmjet mbikëqyrjes së normave të etikës dhe të Kodit Deontologjik të profesioneve infermier/e, mami, fizioterapeft/e, teknik/e laborator, teknik/e imazherie dhe logopedist/e, si dhe mbrojtjes së pacientëve dhe të publikut nga kequshtrimi i profesionit infermier/e, mami, fizioterapeft/e, teknik/e laborator, teknik/e imazherie dhe logopedist/e.

2. Në përmbushje të këtij misioni, Urdhri i Infermierit:

a) kryen regjistrimin e infermier/e, mami, fizioterapeft/e, teknik/e laborator, teknik/e imazherie dhe logopedist/e në regjistrin përkatës të këtij urdhri;

b) mbikëqyr zbatimin e detyrave profesionale, në përputhje me kërkesat e shkencave mjekësore, rregullat e etikës dhe Kodin Deontologjik;

c) siguron udhëheqjen etiko-morale e deontologjike të bashkësisë së infermier/e, mami, fizioterapeft/e, teknik/e laborator, teknik/e imazherie dhe logopedist/e, pavarësinë e ushtrimit të profesionit dhe mbron interesat morale të këtij profesioni;

ç) mbron interesat e pacientëve dhe të publikut nga kequshtrimi i mjekësisë dhe shkelja e

Kodit Deontologjik Mjekësor nga ana e infermier/e, mami, fizioterapeft/e, teknik/e laborator, teknik/e imazherie dhe logopedist/e;

d) bashkëpunon për zhvillimin e standardeve profesionale, për planifikimin dhe hartimin e programeve të formimit profesional për realizimin e specializimeve të ndryshme dhe të edukimit në vazhdim të infermier/e, mami, fizioterapeft/e, teknik/e laborator, teknik/e imazherie dhe logopedist/e;

dh) konfirmon anëtarësinë në Urdhrin e Infermierit, nëpërmjet dhënies së certifikatës së anëtarësimit.

e) garanton që anëtarët e Urdhrit përmbushin detyrimet e programit të ricertifikimit, të vendosur nga institucioni përkatës.

Neni 7

Bashkëpunimi

(Ndryshuar me ligjin nr. 124/2014, datë 25.9.2014; ndryshuar togfjalësh në pikën 3 me ligjin nr. 99/2024, datë 12.9.2024)

1. Urdhri i Infermierit, gjatë kryerjes së detyrave, mban lidhje të vazhdueshme me ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë dhe institucionet e saj të varësisë si dhe me ministrinë, institucionet qendrore dhe organizma të tjerë publikë ose jopublikë, të krijuar sipas legjislacionit në fuqi.

2. Urdhri i Infermierit informon çdo 6 muaj ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë për anëtarësimet e infermierëve, mamive, fizioterapeftëve, teknikëve të laboratorit, teknikëve të imazherisë dhe logopedistëve, për gjykimet disiplinore dhe ecurinë e tyre në të gjitha shkallët e gjykitimit profesional. Ky informacion publikohet edhe në faqen e internetit të Urdhrit.

3. Struktura përgjegjëse për inspektimin në shëndetësi bashkëpunon me Urdhrin e Infermierit gjatë ushtrimit të funksionit të tij.

4. Ministria përgjegjëse për shëndetësinë bashkëpunon me Urdhrin e Infermierit për hartimin e projektligjeve dhe të dokumenteve të rëndësishme në fushën e shëndetësisë.

Neni 8

Buxheti

1. Urdhri i Infermierit ka buxhetin e vet, të cilin e vetadministron në përputhje me rregullat financiare në fuqi.

Burimet financiare të Urdhrit të Infermierit janë:

- a) kuotizacionet e anëtarëve, të miratuara nga Këshilli Kombëtar këtij Urdhri;
- b) tarifat e regjistrimit;
- c) donacione të ndryshme dhe të ardhura të tjera të ligjshme.

2. Të ardhurat që realizon gjatë ushtrimit të veprimtarisë, Urdhri i Infermierit i përdor për të përmbushur misionin e caktuar me këtë ligj.

3. Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Infermierit miraton buxhetin vjetor, si dhe pagat e shpërblimet.

KREU III

ORGANIZIMI DHE DREJTIMI

Neni 9

Organet kryesore

(Shtuar shkronja "ç" e pikës 1 dhe pika 2 me ligjin nr. 124/2014, datë 25.9.2014)

1. Organet kryesore të Urdhrit të Infermierit janë:

- a) asamblетë;
- b) këshillat;

c) komisionet disiplinore.

ç) presidentët e Urdhrit.

2. Zgjedhjet në organet e përmendura në pikën 1 të këtij neni duhet të sigurojnë përfaqësim në masën 30 për qind për çdo gjini, në përputhje me ligjin nr. 9970, datë 24.7.2008, "Për barazinë gjinore në shoqëri.

Neni 9/1

Presidentët e Urdhrit

(Shtuar me ligjin nr. 124/2014, datë 25.9.2014)

1. Presidentët e Urdhrit zgjidhen me votim të fshehtë nga Këshilli Kombëtar dhe këshillat rajonalë të Urdhrit ndërmjet jo më pak se 2 kandidaturash alternative.

2. Këshilli Kombëtar zgjedh Presidentin e Urdhrit të Infermierit, me mandat 5-vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë, me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të tij.

3. Këshillat rajonalë zgjedhin presidentët e këshillave rajonalë. Mandati i tyre është 5 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.

4. Kandidaturat për presidentë të Urdhrit të Infermierit duhet të përmbushin këto kritere:

a) të jenë jo më shumë se në moshën e daljes në pension në momentin e zgjedhjes;

b) të kenë jo më pak se 15 vjet përvojë në profesion;

c) të kenë përvojë dhe të dhëna të besueshme për aftësi komunikimi, organizuese e drejtuese;

ç) të mos kenë marrë masa ndëshkimore disiplinore në 5 vitet e fundit;

d) të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale.

5. Funkzioni i presidentëve të Urdhrit të Infermierit është i papajtueshëm me funksione të tjera administrative, shtetërore apo politike.

Neni 10

Asamblëtë

(Ndryshuar togfjalësh në pikën 1 me ligjin nr. 124/2014, datë 25.9.2014)

1. Asambleja Kombëtare përbëhet nga tërësia e anëtarëve të këshillave rajonalë.

2. Asambleja e Përgjithshme zgjedh Këshillin Kombëtar. Zgjedhjet për anëtarë të Këshillit Kombëtar bëhen çdo 5 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

3. Asambleja rajonale përbëhet nga tërësia e përfaqësuesve të anëtarëve të Urdhrit të Infermierit të qarkut.

4. Zgjedhjet në këshillin rajonal bëhen çdo 5 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

Neni 11

Këshilli rajonal

(Ndryshuar me ligjin nr. 124/2014, datë 25.9.2014)

1. Këshilli rajonal krijohet në bazë qarku dhe përbëhet nga 5 deri 9 anëtarë në varësi të numrit të anëtarëve të Urdhrit të Infermierit, në qark.

2. Këshilli rajonal zgjedh presidentin dhe zëvendësit e tij.

3. Këshilli rajonal emëron dhe shkarkon sekretarin e tij.

Neni 12

Këshilli Kombëtar

(Ndryshuar togfjalësh në pikën 1, shtuar shkronjat "e", "ë" dhe "j" të pikës 1 me ligjin nr. 10462, datë 13.9.2011; ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 124/2014, datë 25.9.2014)

1. Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Infermierit përbëhet nga jo më shumë se 25 anëtarë, si më poshtë:

- a) Presidenti i Urdhrit të Infermierit;
- b) zëvendëspresidenti;
- c) presidentët e këshillave rajonalë;
- ç) një përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë;
- d) një përfaqësues i shkollave të larta të infermierisë;
- dh) një përfaqësues i Fondit të Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor;
- e) dy përfaqësues të Shoqatës së Pacientëve;
- ë) një përfaqësues i Sindikatës së Infermierëve;
- f) pesë anëtarë të zgjedhur nga asambleja kombëtare, sipas qarqeve me numër popullsie më të madhe.

2. Rastet e shkarkimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar parashikohen në statutin, të cilin e miraton Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Infermierit.

3. Këshilli Kombëtar zgjedh presidentin dhe zëvendësit e tij. Mandati i presidentit është 5-vjeçar me të drejtën e një rizgjedhjeje. Funkzioni i tij është i papajtueshëm me funksione të tjera drejtuese në administratën shtetërore.

4. Këshilli Kombëtar emëron dhe shkarkon sekretarin e përgjithshëm.

5. Vendimet e Këshillit Kombëtar merren me shumicë votash, kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij.

Neni 13

Komisionet disiplinore

1. Pranë Këshillit Kombëtar dhe këshillave rajonalë të Urdhrit të Infermierit funksionojnë komisionet disiplinore, të cilat caktohen nga këshillat përkatës.

2. Komisionet disiplinore janë organizma të gjykimit profesional. Ato verifikojnë dhe shqyrtojnë ankesat për shkeljet e etikës mjekësore, të Kodit Deontologjik, si dhe gabimet mjekësore nga anëtarët e Urdhrit të Infermierit.

3. Komisionet disiplinore pranë këshillave rajonalë ushtrojnë përgjegjësi disiplinore të shkallës së parë. Vendimet e tyre ankimohen në komisionin disiplinor të Këshillit Kombëtar, i cili ushtron kompetenca disiplinore të shkallës së dytë.

Neni 14

Kodi Deontologjik

(Ndryshuar toffjalësh me ligjin nr. 10462, datë 13.9.2011)

Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Infermierit miraton Kodin Deontologjik të profesioneve infermier/e, mami, fizioterapeft/e, teknik/e laborator, teknik/e imazherie dhe logopedist/e.

Neni 15

Statuti

Veprimtaria e Urdhrit të Infermierit rregullohet me statut, i cili miratohet nga Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Infermierit.

Neni 16

Masat disiplinore

(Ndryshuar shkronja "c" e pikës 2, shtuar paragraf në pikën 2 me ligjin nr. 124/2014, datë 25.9.2014)

1. Komisioni disiplinor mund të vihet në lëvizje nga një ankesë e paraqitur me shkrim apo me gojë, por ai mund të vihet në lëvizje edhe kryesisht.

2. Komisioni disiplinor heton dhe gjykon, në bazë të fakteve dhe provave të administruara, në seancë dëgjimore. Kur vërtetohet se anëtari ka kryer shkelje të etikës mjekësore, të Kodit Deontologjik ose ka bërë gabim mjekësor, ai jep masat e mëposhtme:

- a) vërejtje me shkrim;
- b) vërejtje me paralajmërim;
- c) gjobë nga 1 500 lekë deri në 100 000 lekë.
- ç) propozim për shkarkim nga funksionet drejtuese në institucione shëndetësore;
- d) pezullim nga e drejta e zgjedhjes në organet drejtuese të Urdhrit të Infermierit deri në 3 vjet;

dh) përjashtim i përkohshëm nga Urdhri i Infermierit për një periudhë deri në 3 vjet.

Gjoka e vjelë, sipas shkronjës "c", të pikës 2, të nenit 16, derdhet në Buxhetin e Shtetit.

3. Përveç masave të parashikuara në pikën 2 të këtij neni, si masë plotësuese, komisioni ka të drejtë t'u caktojë të ndëshkuarve kryerjen e një rikualifikimi ose të studimeve plotësuese.

4. Masat e mësipërme disiplinore mund të shlyhen, nëse ndaj anëtarit, brenda 1 viti nga data e dhënies së tyre, për shkronjat "a" dhe "b" të këtij neni dhe brenda 3 vjetëve nga data e dhënies, për shkronjat "ç", "d" dhe "dh", nuk është marrë ndonjë masë tjetër disiplinore.

Neni 17

Ankimi

1. Ankesat kundër vendimeve për marrjen e masave disiplinore nga komisionet disiplinore, pranë këshillave rajonale të Urdhrit të Infermierit paraqiten në komisionin disiplinor të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Infermierit brenda 30 ditëve nga komunikimi me shkrim i vendimit.

2. Komisioni disiplinor i Këshillit Kombëtar, brenda 30 ditëve nga marrja e ankesës, detyrohet të japë vendimin për ankesën e paraqitur. Vendimi i komisionit disiplinor të Këshillit Kombëtar është përfundimtar.

3. Kundër vendimit të komisionit disiplinor të Këshillit Kombëtar, personi ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës brenda 30 ditëve nga data e komunikimit me shkrim të vendimit.

Neni 18

Financimi

Urdhri i Infermierit financohet nga shteti për një periudhë dyvjeçare. Masa dhe mënyra e këtij financimi përcaktohen me akte nënligjore të Këshillit të Ministrave.

KREU IV

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 19

Organizimi i zgjedhjeve

1. Ministri i Shëndetësisë ngarkohet të ngrejë një komision të përkohshëm, i cili, brenda 3 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, organizon zgjedhjet e para të këshillave rajonale dhe të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Infermierit.

2. Me zgjedhjen e Këshillit Kombëtar, komisioni i përkohshëm shkrihet.

Neni 20

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr. 5293, datë 8.5.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**